



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT 12. 09. 2023
14-782/01-183599, më
23

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), nenit 14 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi për procedurën dhe afatet për dërgimin e kërkesave tek përmbaruesi të rasteve të reja të borxheve të personave fizikë dhe personave juridikë ndaj Komunës së Prishtinës, si në vijim:
 - 1.1. Secila drejtori përkatëse nga fushë veprimi i saj është e obliguar që brenda afatit prej 30 ditëve nga momenti i kalimit të afatit për kryerjen e obligimeve financiare nga personat fizikë ose personat juridikë ndaj Komunës së Prishtinës, kërkesën duhet ta procedoj tek Zyra Ligjore e Komunës, me qëllim që të procedohet tutje në procedurë të përmbarimit;
 - 1.2. Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës brenda afatit prej 30 ditësh është e obliguar që kërkesat sipas paragrafit 1.1 të këtij vendimi, t'i dërgoj tek përmbaruesi.
2. Detyrohen të gjitha drejtoritë dhe njësitë përkatëse të Komunës së Prishtinës që në kuadër të Urdhëresës për Pagesë për Ndëshkim me Gjobë Mandatore duhet të nxjerrë "Vendim" në harmoni me dispozitat e nenit 45,46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, në mënyrë që vendimi i organit administrativ të ketë cilësinë e dokumentit përmbarues ashtu siç parashihet me nenin 22 dhe 23 parag.2 të Ligjit Procedurës Përmbarimore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha drejtoritë dhe njësitë përkatëse të Komunës së Prishtinës si dhe Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës.
4. Përgjegjësia për mos respektimin e procedurave dhe afateve të përcaktuara me këtë vendim, bien mbi drejtorinë përkatëse dhe zyrën ligjore.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U DORËZOHET:

- Të gjitha drejtorive dhe njësive të Komunës;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Zyrës Ligjore; dhe
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

